

A duhet të njoh gjuhë tjetër?

Pjesa dërmuese e institucioneve kanë kurse në gjuhë angleze, por preferohet që të shqyrtoni faqet oficiale të institucioneve në të cilat planifikoni të shkoni që të shihni se në cilën gjuhë ligjerohen lëndët për të cilat jeni të interesuar.

Gjatë aplikimit preferohet njohja e gjuhës angleze.

Informohuni edhe për mundësinë e ndjekjes së kursit intenziv Erasmus të gjuhës së shtetit që do të vizitoni.

Konsiderohet se mësimi i gjuhës së shtetit në të cilin do të qëndroni do tu mundësojë shfrytëzim më të mirë të qëndrimit tuaj.

A duhet vetë ta organizoj vendosjen?

Erazmus koordinatori i institucionit në të cilin do të qëndroni do t'u ndihmojë të gjeni vendosje. Zakonishtë ofrohen mundësi për tu vendosur në konvikte studentore ose mundësi për vendosje private. Shpenzimet ndryshojnë në varëshmëri nga shteti dhe lloji i vendosjes.

Si duket Erasmus në numra ?

Erasmus është programi më i përhapur Evropian. Që nga fillimi i programit në vitin 1987 rreth 90% i univerziteteve dhe 2 milion student kanë marë pjesë në të. Buxheti vjetorë i Erasmus tejkalon 400 milion euro dhe në të marin pjesë 3.200 institucione të arsimit të lartë nga 33 shtete.

A do to më prolongohet diplomimi/magjistrimi ?

Learning agreement shfrytëzohet për mbledhjen dhe pranimin e të ariturave studimore. Kjo kontratë garanton pranimin e kredive gjatë planifikimit të qëndrimit studimorë në një shtet të huaj. Lidhet midis institucionit amë dhe atij nikoqir, dhe duhet doemos të nënshkruhet para nisjes. Në kontratë në mënyrë të detajuar përcaktohen lëndët që do t'i dëgjojë studenti. Shfrytëzimi i learning agreement është i obligueshëm për stipendionet Erasmus. Pranimi i kredive të fituara mundësohet nëpërmjet nënshkrimit të personit përgjegjës të institucionit nikoqir (Erasmus koordinatori). Pas nënshkrimit kontrata bëhet juridikishtë obliguese për tre palë: studentin, institucionin amë dhe atë nikoqir. Keni kujdes pasi kreditë e disa lëndëve nuk pranohen në Maqedoni. Konsultohuni me Erasmus koordinatorin e Fakultetit tuaj.

Çka nëqoftëse shkoj atje, por nuk më pëlqen?

Nëqoftëse shkoni atje dhe nuk ju pëlqen mundeni të ktheheni dhe ti vazhdoni studimet e rregullta në Maqedoni me kusht të mos keni humbur shumë ligjerata. Nënkuptohet që duhet të ktheni stipendionin e marrë.

Ku mundem të shkoj?

Mundeni të shkoni në çdo institucion të arsimit të lartë me të cilin institucioni juaj amë ka nënshkruar marrëveshje për bashkëpunim ndërkombëtarë (lista mundet të gjindet në faqen e institucionit), dhe e cila ka fituar Çarter univerzitar Erasmus.


Eksemplarë të kësaj broshure mundet të meren në

Agjencioni Nacional për Programe Arsimore Evropiane dhe Mobilitet

Порта Бушаковец, А2-1
МК-1000, Скопје Република Македонија
Т. + 389 23 109 045 Ф. + 389 23 109 043

www.na.org.mk

ЕРАЗМУС
Најчесто поставувани прашања



www.na.org.mk

Çka është Erasmus?

Erasmus është program lider i UE për arsim të lartë i cili çdo vit u mundëson 200.000 studentëve të studjojnë dhe punojnë në shtet të huaj, dhe përkrah edhe bashkëpunim midis institucioneve të arsimit të lartë nga mbarë Evropa. Është e hapur edhe për profesorë dhe persona tjerë të punësuar në institucionet e arsimit të lartë të cilët dëshirojnë të bëjnë trajnim në ndonjë shtet tjetër Evropian.

Cilat janë qëllimet e programit?

Erasmus është shëndruar në fuqi lëvizëse të modernizimit të arsimit të lartë në Evropë dhe inspirim për procesin e Bolonjës. Qëllimi bazë i programit është krijimi i Hapësirës evropiane të arsimit të lartë si dhe promovimi i inovacioneve në mbarë Evropën.

Pse të mar pjesë?

Studimet e kryera nga ana e Komisionit Evropian për ndikimin e Erasmus mbi aplikantët kanë treguar se qëndrimi në shtet të huaj jo vetëm që sjell zmadhimin e diturive akademike,por mundëson edhe përfitimin e aftësive ndërkombëtare si dhe një shkallë më të lartë të pavarësisë. Shkëmbimet e stafit akademik dhe personave të punësuar në institucionet e arsimit të lartë kanë rezultate të ngjajshme. Përpos mobilitetit programi ofron mundësi për bashkëpunim midis institucioneve të arsimit të lartë siç janë: programet intenzive, projektet dhe rrjetet multilaterale.

Cilat parakushte duhet ti plotësoj për të aplikuar?

Të kualifikuar për Erasmus janë studentët e rregullt që kanë përfunduar vitin e parë të studimeve.

Duhet të jeni nënshkretar i Republikës së Maqedonisë ose të keni leje qëndrimi.

Nëqoftëse njëherë keni shfrytëzuar Erasmus stipendion nuk keni të drejtë aplikimi. Studentët e huaj nuk kanë të drejtë aplikimi.

Vlera e shtuar nga studimi ose puna në shtet të huaj do të pasurojë CV-në tuaj dhe do tu ndihmojnë të jeni më kompetitiv në tregun e punës.

Pse programi quhet Erasmus?

Programi e ka fituar emrin sipas humanistit dhe teologut Desiderius Erasmus nga Roterdami (1465-1536), i cili për nevojat e studimeve dhe punës së tij ka vizituar një pjesë të madhe të qendrave më të mëdha arsimore të kohës duke përfshirë këtu edhe Parisin,Luvenin dhe Kembrixhin.

Tërë pasurinë e tij ia ka lënë Univerzitetit të Bazelit dhe është inspirim për programin e mobilitetit që sot mban emrin e tij.

Duke marë inspirim nga vepra e tij jetësore, programi Erasmus i kushton një rëndësi të madhe mobilitetit të të mësuarit dhe zgjerimt të mundësive dhe kontakteve profesionale.

Çka përfitohet nga Erasmus?

Aplikimi është i thjeshtë kurse stipendionet sigurohen nga ana e UE. Do të merni çdo muaj nga afërsisht 310 euro për studim dhe 450 euro për punë praktike që do tu ndihmojë në mbulimin e shpenzimeve për rrugë dhe jetesë.

Mjetet lëshohen si sumë e përgjithshme në llogarinë tuaj bankare dhe nuk ka nevojë të arsyetohen. Një pjesë e madhe e studentëve në raportet përfundimtare shkruajnë se qëndrimi ka qenë eksperienca më e mirë në jetë. Studimi në mënyrë të ndryshme dhe nga një perspektivë tjetër zakonishtë shkakton që studentët pas kthimit të jenë më të motivuar dhe të realizojnë rezultate më të mira në studimet e tyre.

Përvoja është interesante, sfiduese dhe do ta mbani mend gjatë gjithë jetës tuaj.

Sa gjatë mundem të qëndroj dhe kur duhet të aplikoj?

Mobiliteti zgjat midis 3-12 muaj. Zakonishtë fillojnë në shtatorë,por mundet të fillojnë edhe më vonë. Aplikimi për semestrin verorë bëhet në nëntorë kurse për atë dimërorë në muajt maj-qershor.

A duhet të paguaj shpenzimet e studimit?

Institucioni në shtetin e huaj nuk guxon të kërkojë pagesë nga Erasmus studentët (duke përfshirë këtu participim,provime, bibliotekë, laboratore ose regjistrime të ndryshme). Nëqoftëse periudha e studimit është më e vogël se 1 vit ju paguani shpenzimet e studimit në institucionin amë. Nëqoftëse studimi zgjat saktë 1 vit, drejtohuni Zyrës për bashkëpunim ndërkombëtarë pranë institucionit tuaj për informata.